REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KËSHILLI I BASHKISË DEVOLL

NJOFTIM

Nr.4209 Prot **Bilisht më 26.10.2026**

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Devoll

Të Nderuar

Njoftoheni se ditën **e Premte** në datën **30.10.2026**, ora **12:00**, në sallën e Këshillit të Bashkisë Devoll, do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4 nenit, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.09.2026.
3. Projekt-Vendim Nr.78 Datë 23.10.2026 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën ekonomike dhe fondet e buxhetit vendor për muajin Shtator 2026.
4. Projekt-Vendim Nr.79 Datë 23.10.2026 "Për kalimin në pronësi të trojeve të dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish komunat dhe ish këshillat e rretheve pas datës 10.08.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit 24/2012 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij" dhe për autorizimin e kryetarit të bashkisë Devoll ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhjen e kontratës përpara noterit për shitjen e trojeve të dhëna për ndërtim.
5. Projekt-Vendim Nr.80 Datë 23.10.2026 "Për miratimin e dhënies me qira të pasurive me numër 408/1 dhe 408/2 të cilat ndodhen në fshatin Qytezë.
6. Projekt-Vendim Nr.81 Datë 23.10.2026 " Për miratimin e linjave për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit."
7. Projekt-Vendim Nr.82 Datë 26.10.2026 "Për miratimin e bashkëortakërisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Kapshtica Solar Shpk dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes për dhurimin e kuotave"

Të Tjera :

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të Këshillit janë si më poshtë:

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori"nr 9 Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com

- **Komisioni i financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit te Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Ekonomia Vendore, Turizmi dhe Zhvillimi Rural .**

Pika 4,7 e rendit të ditës.

,*Znj*.Ermena Xhaci ,*Z*.Eroldi Begolli , *Z*.Eduard Maho , *Z*.Oliver Mulla .

- **Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore,Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Arsimit, Sporteve dhe Clodhjes,Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve ,Emërtimeve.**

Pika 3, 6 e rendit të ditës.

Z.Trifon Meraku, *Znj*.Valbona Spaho,*Znj*. Imelda Cucka , Z.Festim Kaso , *Znj*. Albana Skoti

- **Komisioni I Bujqesise, Pyjeve, Menaxhimit te ujrave, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Biodiversitetit.**

Pika 5 e rendit të ditës
Znj.Esmeralda Medolli, Znj. Lindita Cokani, Z.Trifon Meraku, Znj. Imelda Cucka, Z.Vladimir Kello.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen datë28.10.2026 – 29.0.2026
Ora 13:00-15:00

Mbledhja është e hapur!

KRYETARI I KESHILLIT
ALFREDI GJATA

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr 1 Rr "24 Tetori"nr 9 Bilisht Tel.Fax: +355 811 2 2288 e-mail bashkiadevoll@gmail.com